



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-246

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-033 PËR
DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR
ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË
PRIVATIZIMIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-033
PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË
PRIVATIZIMIT**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e nenit 25 të Shtojcës së ligjit bazik nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (Gazeta Zyrtare Nr. 20, datë 22 Shtator 2011).

Neni 2

1. Neni 25 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafi 8. riformulohet me tekstin si në vijim:

8. Të gjitha kërkesat dhe dokumentet përcjellëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, kurse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të sigurojë, me propozimin dhe burimet e saj, përkthimin e tyre në gjuhën angleze.

2. Neni 25 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafet 9. dhe 10. fshihen në tërësi.

Neni 3 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-246
14 mars 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI